



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.32, datë 23.01.2020

PËR

**KËRKESËN E ZNJ. {...} PËR KOMANDIMIN NË POZICIONIN E
NDIHMËSMAGJISTRATES NË GJYKATËN E LARTË**

Këshillit të Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 4 dhe 147/1/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 dhe 89 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 44, 53, pikat 6 dhe 7, nenin 57, pikat 1 dhe 4, si edhe në nenin 167, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesën e magjistrates {...}për dhënie pëlqimi për komandimin e saj si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë.
2. Të njohë të drejtën e znj. {...} për të zgjedhur në një nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë që kanë një pozicion të lirë të përhershëm.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarës znj. {...}sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR